

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 27 MARS 2003**

T R A N S K R I P T

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 27. 03. 2003. GOD.**

**MARS – MART
2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendosjen e tatimit në pronën e palujtshme në Kosovë (2003/3)
3. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 3 Prill 2003
5. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrës të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Прво разматрање Нацрт Закона о успостављењу пореза на некретнине (2003/3)
3. Разматрање Извештаја о стању правосућа на Косову
4. Предлог дневног реда за пленарну седницу 3 Априла 2003
5. Поставаљање питања

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

Sekretariati i Shërbimeve të Kuvendit - Ndërtesa e Kuvendit / Ndërtesa e Qeverisë - Rruga Nëna Tereze - Kosovë / Posta e UNMIK-ut
Секретариат скупштинских служби - Скупштина Косова / зграда Владе - улица Мајке Терезе - Косово / Пошта УНМИК-а
Assembly Services Secretariat - Assembly of Kosovo / Government Building - Mother Theresa Street - Kosovo / UNMIK Post



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. First reading of Draft Law on immovable property tax in Kosovo (2003/3)
3. Review of the Report regarding Kosovo's judicial system
4. Proposal for agenda of 3 April 2003 for Plenary Meeting
5. Questions

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

T R A N S K R I P T
NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 27 MARS 2003

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES, OLIVER IVANOVIQ, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes kolegë deputetë. Mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare.

Shpresoj se e keni të njohur rendin e ditës të seancës së sotme dhe po ashtu jeni të përgatitur për punën në këtë seancë.

Pikë e parë e rendit të ditës të kësaj seance është **Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.**

Besoj se Procesverbali është konform asaj që ka ngjarë në Parlament. Megjithatë, nëse ka kush ndonjë vërejtje, mund ta paraqesë me shkrim dhe, nëse shihet e arsyeshme, ta theksojë edhe gojarisht.

E ka fjalën zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Mendoj se paraprakisht duhet të kërkohet se a pajtohem me këtë rend të ditës apo jo. Ne mendojmë se pika e tretë, ku flitet për shqyrtimin e **Raportit mbi gjendjen e gjyqësisë në Kosovë**, duhet të shtyhet dhe të kërkohet të vijë përgjegjësit për këtë lëmi

nga ndërkombëtarët dhe të jenë prezent në Kuvend kur ne bëjmë shqyrtimin e kësaj çështjeje shumë të ndieshme, sepse ne kemi bazë që ky Kuvend, para disa muajve, ka kërkuar në rekomandimet e veta që, kur bëhet fjalë për gjendjen e sigurisë dhe drejtësisë e të tjera, ato organe kompetente të vijnë dhe së paku një herë në muaj para këtij Kuvendi të raportojnë për punën e vet. Kjo është një çështje shumë e ndieshme, shumë problematike dhe fatkeqësisht edhe gjykatat ... drejtësi nuk ka në Kosovë por ka padrejtësi dhe kjo çështje kërkon përgatitje serioze dhe gjithësesi duhet të jenë prezent njerëzit kompetentë këtu në Kuvend dhe t'i dëgjojnë mendimet e deputetëve, kërkesat e tyre, e pastaj të mund të vijmë deri te përfundimet.

Komisioni për çështje legislative-kushtetuese ka punuar në këtë drejtim, por mendoj se kur t'i hyhet e të shqyrtohet, duhet të jenë prezent edhe ndërkombëtarët. Prandaj, mendoj se kjo pikë e rendi të ditës sot, mendimi ynë është, nuk mund të shqyrtohet sepse edhe nuk ka përgatitje në këtë drejtim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, e ka fjalën zoti Luzha.

BERAT LUZHA:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka kërkuar 3 herë radhazi, më 12 nëntor; më 1 dhjetor dhe 27 janar, që në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të shqyrtohet gjendja në gjyqësinë e Kosovës. Në kërkesë kemi precizuar se në mbledhje duhet të prezentojnë përgjegjësit e gjyqësisë, në mënyrë që edhe ata t'i dëgjojnë diskutimet, kurse deputetët prej tyre të marrin përgjigje përkatëse. Prandaj, në këtë mbledhje, Kryesia është dashur t'i ftojë përgjegjësit nga UNMIK-u, përkatësisht zëvendësin e PSSP-ës për gjyqësi dhe polici, zotin Zhan Kadi si dhe përgjegjësit nga Ministria e Shërbimeve Publike, përkatësisht nga Departamenti i Administratës Gjyqësore të kësaj Ministrie. Debatimi në Kuvend, pa përgjegjësit kryesor të gjyqësisë, mendojmë se do të dilte i that, i pakuptimt dhe pa efekt.

Duke pasur parasysh këtë fakt dhe në mbështetje të rregullës 22, pika 6 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar kërkon që pika e 3-të e rendit të ditës – **Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës**, të shtyhet për një mbledhje tjetër kur të krijohen kushtet përkatësisht kur të prezentojnë personat përgjegjës për këtë çështje. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Desha ta jap një sqarim. Materiali është përgatitur për këtë pikë të rendit të ditës. Kryesia ka pa të arsyeshme ta vendosë në rend të ditës, por është e drejtë e grupeve parlamentare dhe arsye ka, që thanë parafolësit, që të jenë të pranishëm

përgjegjësit. Prandaj, mënyra më e mirë është që, në qoftë se s'ka diskutues tjerë, me anë të votimit të deklarohemi për këtë kërkesë të dy grupeve parlamentare. Urdhëroni. E ka fjalën zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Kjo është pikë që është vënë në rend të ditës nga Kryesia e Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë e dijnë këtë, dhe kanë arsyet e veta pse është vënë, sepse në procedurë të rregullt është kërkuar një analizë e cila është sjellë nga komisioni përkatës dhe është e paarsyeshme të diskutohet për të.

Në këtë rast, kemi një kontestim për shkak të mospranisë së njerëzve që janë përgjegjës. Është shumë e arsyeshme, që ata njerëz që janë përgjegjës, kur të trajtohen çështjet e ndieshme të cilat ata i kanë, do të thosha, kompetencat kryesore të jenë prezent. Mirëpo, edhe shtyerja, në kuptimin e paadresuar të kohës, mua më duket se nuk ka kuptim. Sepse, çka do të bëjmë ne, nëse edhe në mbledhjen tjetër e radhisim, njerëzit nuk vijnë e as në të tretën nuk vijnë, atëherë ne do ta sjellim vetëveten në situatë të pakëndshme.

Nëse eventualisht do të duhej të shtyhet, atëherë duhet paraprakisht të dihet kur ndodh kjo. Jo në kuptimin e paadresimit të pakohë, sepse atëherë çdo gjë do të ç'vlerësohet deri në pakufij, ndërsa unë kujtoj se ekziston një analizë e mirë dhe e dobishme mbi të gjithë në të cilën duhet të bisedohet e sidomos në nivelin e rekomandimeve të saj. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mendoj se ne, në qoftë se e shtyjmë këtë çështje tash me votim, do të kërkojmë menjëherë me shkresë që të jenë prezent në seancën e ardhshme plenare, por në qoftë se ata kanë arsye të veçanta, ne mund të presim edhe një javë tjetër. Do të thotë maksimum dy javë, por ne do t'u propozojmë që në seancën e ardhshme të vijnë dhe të jenë të pranishëm këtu.

Prandaj, nuk po hap debatin. Ju lutem, nuk ka debat, por po e vëmë në votim.

Kush është për propozimin që ta shtyjmë për njërën nga seancat e ardhshme këtë pikë të rendit të ditës? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Dy, kundër.

A abstenon ndokush? Katër, abstenojnë.

Konstatohet se miratohet propozimi që pika e përmendur të heqet nga rendi i ditës i kësaj seance deri në javën e ardhshme ose eventualisht, në qoftë se ka arsye të mjaftueshme, për një seancë të radhës tjetër.

Vazhdojmë me pikën tjetër: **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë.**

Më lejoni t'i përsërisht ministrit e pranishëm dhe ftoj menjëherë ministrin sponsorues të këtij Ligji ta marrë fjalën. Zoti ministër, foltorja është e juaja.

ALI SADRIU:

I nderuar kryetar, e nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Jam sot këtu për të propozuar reformat për vjeljen e të ardhurave në sistemin tonë fiskal. Si një prapavijë për këto reforma, unë do të theksoja, Kosova ka tejkaluar shumë sfida në ndërtimin e sistemit të saj tatimor. Bazuar në rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, ne kemi marrë një vendim fillestar në vitin 1999 për të vendosur disa tatime, siç janë: doganat; akcizat dhe tatimi në qarkullim, të vjelura që të gjitha në vijat kufitare. Pastaj, në fillim tashmë ekonominë vendore, kur UNMIK-u miratoi një tatim mbi hotelierinë, ushqimin, pijen dhe pastaj kaluam në tatimin e paragjykuar që i dedikohet aktiviteteve afariste. Pasi që përkrahja prej donatorëve zvogëlohej, ne rritëm përpjekjet për tatimin vendor duke vendosur tatime standarde, me bazë të gjerë të njohura ndërkombëtarisht.

Tatimi i parë standard, është vendosur në vitin 2001 kur u vendos TVSH-ja, tatim ky që paraqet formën më të rëndësishme të tatimit në konsum e që përdoret në më shumë se njëqind vende të shteteve në mbarë botën.

Tatimi i dytë standard, është vendosur në prill të vitit 2002, kur Kosova futi në përdorim tatimin në fitim, për të tatuar fitimet afariste të organizatave afariste.

Një hap madhor drejt tatimit të tretë standard, tatim ky mbi të ardhurat e personave fizikë, ishte bërë në prill të vitit 2002 kur u vendos tatimi mbi të ardhurat personale në paga, i cili për vitin 2003 ka pësuar ndryshime.

Të nderuar deputetë,

Sot para jush, propozojmë Projektligjin mbi vendosjen e tatimit mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Ky është një propozim për të vendosur një tatim komunal mbi pronën e paluajtshme, me qëllim që kuvendeve t'iu ofrojmë të ardhura vetjake të mjaftueshme për të përmbushë përgjegjësitë të cilat iu janë dhënë sipas Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë.

Projektligji ofron bazën ligjore për komunat e çertifikuara nën Rregulloren e UNMIK-ut 2000/23 mbi programin pilot për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë, që do të vazhdojë të mbledhë tatimin në pronë dhe për të gjitha komunat tjera për të fituar tatimin në pronë.

Prej burimeve të ndryshme në të ardhura lokale të shfrytëzuara në shtetet tjera, më premtuesi për Kosovën, do të thonim, është tatimi në pronë. Tatimi në pronë nxjerr të ardhura stabile të cilat rriten së bashku me progreset e zhvillimit ekonomik dhe është vështirë për t'iu shmangë dhe nuk paraqet ndonjë problem të madh për t'u vjelë.

Me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Kosovës, kuvendeve iu janë dhënë përgjegjësi të rëndësishme për shpenzime, duke përfshirë planifikimin urban, rural, shfrytëzimin e tokës, mbrojtjen e ambientit lokal, shërbimet publike, siç janë arsimi parësor dhe dytësor, përkujdesi parësor shëndetësor, shërbimet e zjarrfikësve dhe ato emergjente, pastaj shërbimet shoqërore dhe strehimi. Këtyre komunave u duhet tatimi në pronë ashtu që këto të mund të vjelin të ardhurat e tyre vetjake në mënyrë që t'i përmbushin këto përgjegjësi.

Gjatë vitit të kaluar, ne testuam me sukses implementimin e tatimit në pronë, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/23 dhe të ashtuquajturin program pilot për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë. Ai, megjithatë, vlenë vetëm për tatimet e vendosura në vitin 2002 ku edhe më tej vazhdon në mënyrë që të vazhdohet kjo iniciativë dhe kur pretendojmë ta vazhdojmë këtë iniciativë ne propozojmë një ligj gjithëpërfshirës, i cili vendos tatimin në pronë mbi të gjitha pronat e paluajtshme që i nënshtrohen tatimit përveç nëse ajo është mënyra e specifikuar e cila përjashtohet nga ligji pronat e përjashtuara, rreptësisht të kufizuara, në pronat që janë në pronësi apo në shfrytëzim të institucioneve vetëqeverisëse të Kosovës, qeverive të jashtme, agjencive të tyre, Kombeve të Bashkuara, KFOR-it, agjencive joqeveritare me statut të përfitimit publik sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/22.

Pjesa e parë, definojnë objektin e tatimit, bazën tatimore, tatimpaguesit dhe normat tatimore. E gjithë prona e paluajtshme i nënshtrohet tatimit përveç në ato raste kur në mënyrë specifike përjashtohen me ligj, siç i cekëm më lart.

Baza tatimore e pronës, është vlera e tregut të pronës. Ministria për Ekonomi dhe Financa, do të përshkruajë në udhëzimin administrativ metoda të njëtrajtshme për të vendosë vlerën e tregut të pronës së paluajtshme. Kjo do të vendoset për herë të parë, meqë në pilotprogramin kjo kompetencë ka qenë në nivel të kuvendeve komunale dhe kemi pasë shumë reagime në vlerësimin e vlerës reale të tregut, andaj kemi formuar një grup i cili do të merret m'u me këtë çështje për t'iu ndihmuar kuvendeve komunale që vlerësimi i objekteve të jetë sa më real.

Tatimpaguesit në pronë, janë në rend të parë titullarët e pronës. Nëse titullarët e pronës nuk mund të përcaktohen, atëherë tatimpaguesi është personi i cili shfrytëzon apo banon atë pronë. Tatimi në pronë llogaritet, duke shfrytëzuar shkallën tatimore mbi bazën tatimore. Shkalla tatimore vendoset në kuvende komunale përbrenda parametrave 0.05 deri në 0,2% të përcaktuar me Ligjin e propozuar.

Pjesa e dytë përcakton përgjegjësitë e komunave. Si rregull e përgjithshme, kuvendet kërkohet të vendosin dhe mirëmbajnë një bazë të dhënave të tatimit në pronë që përmban informatat mbi tokën, ndërtesat, pronat dhe shfrytëzuesit e pronave. Baza e të dhënave të komunave mbi tatimin në pronë do të jetë e lidhur me regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme i cili do të themelohet nga Agjensia Kadastrale e Kosovës. Kuvendet, gjithashtu, duhet të adaptojnë standarde të unifikuara të vlerësimit të bazës së vlerësimit të sistemit të bazuar dhe përpunuar në sistemin kompjuterik.

Kriteriumet specifike për vlerësimet standarde, do të specifikohen në udhëzimet administrative të lëshuara nga Ministria për Ekonomi dhe Financa. Pjesa e dytë, gjithashtu përmban dispozitat e nevojshme për të mbledhur dhe futur në fuqi tatimin. Faturat tatimore lëshohen në baza vjetore dhe paguhen në dy pjesë. Rregullat për të detyruar mbledhjen e tatimit dhe e drejta e ankesës, janë procedura të veçanta e të ngjashme me ato të shfrytëzuesve të tatimeve tjera.

Dispozitat përfundimtare, kërkojnë që të gjitha komunat të certifikohen nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Për kureshtjen tuaj, bazuar në pilotprogramin e mëparshëm, gjer tani kemi certifikuar 21 kuvende komunale; i kemi të gatshme edhe 4 që do të ndodhin javën e ardhshme, në mënyrë që administrata tatimore të vendosë dispozitat transitorë për komunat e certifikuara nën Rregulloren e UNMIK-ut 2001/23, e cila do të skadojë kur të hyjë në fuqi Ligji mbi tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë.

Përmbledhje: Në fund, në mënyrë që sistemi tatimor i Kosovës të vihet sa më afër standardeve të Bashkësisë Evropiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, Ministria për Ekonomi dhe Financa, propozon Projektligjin tatimor, të theksuar më lartë. Ky nuk është tatim i ri por vazhdim i atij që kemi zbatuar gjer tani me pilotprogram e që unë propozoj për ta vendosur. Pra tatimin në pronë thjesht e kodifikon dhe bën të përhershëm programi testues i cili është aplikuar gjer tani e që është i vendosur me Rregulloren e pilotprogramit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti ministër.

Hap debatin në parim, për Ligjin e propozuar. Janë paraqitur disa diskutues dhe më lejoni që përparësi t'u jap kryetarëve të komisioneve, nëse dojnë, sepse s'mund t'i obligojmë. Meqë është paraqitur me kohë dhe për shkak të rrespektit të gjinisë e të profesionit, do t'ia jap fjalën profesoreshë Nerxhivane Dautit.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,
Ligji i propozuar mbi vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë, krijon një kornizë adekuate ligjore për vendosjen e tatimit mbi pronën e paluajtshme në Kosovë dhe në mënyrë të detajizuar përcakton standardet dhe procedurën të cilën duhet zbatuar komunat në administrimin e tatimit. Sipas këtij Ligji, të ardhurat e mbledhura nga tatimi në pronë do të shfrytëzohen nga komunat në përputhshmëri me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësinë.

Ligji i propozuar, përcakton se tatimi mbi pronën do të vihet në të gjitha pronat e paluajtshme në Kosovë, përveç atyre të përjashtuara nga pagimi i tatimit të përcaktuara në mënyrë precize në nenin 7 të tij. Derisa me nenin 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/23, të datës 29 shtator 2001 mbi Programin eksperimental për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë, është paraparë se shkallën e tatimit e cakton komuna, e cila nuk mund të kalojë 2% të bazës tatimore, Ligji i propozuar është më i avancuar dhe më preciz sepse i ofron mundësi kuvendit komunal të çdo komune që të vendosë shkallën tatimore të tatimit mbi pronën në baza vjetore ndërmjet 0.05 dhe 2% të vlerës së pronës së paluajtshme.

Në këtë drejtim, sipas këtij Ligji, shkalla tatimore mund të ndryshojë ndërmjet kategorive specifike të pronave, siç janë: prona e banuar; prona komerciale; prona industriale dhe prona bujqësore.

Ligji i propozuar, përmban gjithësej 25 nene ku në mënyrë të detajizuar rregullon çështjet thelbësore e që kanë të bëjnë me informacionin për tatimin mbi pronën; vlerësimin e pronës; faturat tatimore; pagesat e tatimit; shtyrjet tatimore; vjeljen e detyrueshme; humbjen e pronës; ndëshkimet; kamatat dhe ankesat administrative.

Ligji i propozuar është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, sepse ky është Ligji i veçantë dhe i mëvetësishëm i Kosovës që rregullon politikën tatimore fiskale në pronën e paluajtshme në Kosovë, të bazuar në standardet e larta ndërkombëtare dhe i harmonizuar me normat dhe parimet bazë të konventave ndërkombëtare.

Përnga aspekti i rëndësisë së ekzistimit dhe implementimit të tij, Ligji është i nevojshëm në drejtim të plotësisë së zbratësirave juridike që kanë përcjellur Kosovën e pasluftës në këtë sferë, duke ofruar kështu një bazë të unifikuar për përgjegjësi të komunave që të themelojnë bazën e të dhënave për tatimin e pronave të paluajtshme, formën dhe mënyrën e mbledhjes së tatimeve nga personat fizikë dhe juridikë, si dhe mënyrën e administrimit të tatimeve nga komunat.

Marrë në tërësi, Ligji i propozuar plotëson kushtet për procedim të mëtejshëm me qëllim të miratimit. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, përkrah këtë Ligj të propozuar.

Të gjitha vërejtjet dhe sygjerimet konkrete, lidhur me këtë Ligj, do t'ua prezentoj në formë të amendamenteve konkrete komisioneve kompetente të Kuvendit. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se t'ia jap fjalën zotit Haki Shatri, kryetar i Komisionit, t'ju bëj me dije se të pranishëm në seancë janë 94 deputetë dhe ju lus celularët t'i ç'kyçni. Kjo vlenë përgjithmonë dhe mos ta përsëris.

HAKI SHATRI:

T'falemnderit zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra, Për rëndësinë e aprovimit të këtij Ligji në Kuvend folën edhe prezentuesi i Ligjit, zoti ministër Ali Sadriu dhe parafolsja Nerxhivane Dauti me përmbajtjen e të cilëve pajtohem plotësisht, prandaj edhe nuk do ta elaboroj më tutje rëndësinë e tij. Me këtë rast, desha të them vetëm 2-3 çështje shkurtimisht që lidhen me zbatimin në jetë të këtij Ligji pas aprovimit.

Mendoj se është pak absurde që na mungon Ligji mbi pronën dhe nxjerrja e Ligjit për tatimin mbi pronën. Mirëpo, ky nuk është faj as i ministrit të financave as i Ministrisë.

Dikush tjetër duhet të jetë sponsorues i Ligjit për pronën, prandaj këtë vetëm e përmend si një çështje që do të duhej kompletuar në gamën e ligjeve që do të miratohen.

Mendoj se në zbatimin e deritashëm të Pilotprogramit për tatimimin në pronë, në komuna ka ndodhur një dukuri që duhet pasur parasysh pas miratimit të këtij Ligji e kjo është vënia e vlerave të tatimit në tarifata e ndryshme për të njëjtën pasuri në komunat e ndryshme. Prandaj, mendoj se Ministria e Financave, pas aprovimit të këtij Ligji, duhet të ndihmojë komunat që me akte nënligjore dhe me udhëzime tjera administrative, t'iu ndihmojë që tatimpaguesit të janë në pozitë të barabartë në të gjitha komunat.

Çështja e dytë, e cila mendoj se duhet të kihet parasysh, është të bëhen përpjekje që, menjëherë pas aprovimit të këtij Ligji, ky Ligj të zbatohet në tërë territorin e Kosovës.

Dhe, një çështje që besoj është me rëndësi në zbatimin e këtij Ligji, është se meqë ky Ligj prek pothuaj çdo familje kosovare, është shumë me rëndësi që Ministria e

Financave, në bashkëpunim me njësitë përkatëse të komunave që zbatojnë këtë Ligj, të marrin masa për informimin e mirëfillt të çdo qytetari rreth obligimeve që dalin nga ky Ligj. Sepse, pasojat, në qoftë se nuk janë mirë të informuar qytetarët e që janë obligues tatimor nga ky dokument, do të jenë bukur të rënda për qytetarët dhe kemi për obligim që t'i informojmë paraprakisht.

Mendoj se ky Ligj i plotëson të gjitha kriteret që të miratohet në këtë fazë në parim në Kuvend. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Ibush Jonuzi, le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

IBUSH JONUZI:

Zoti kryetar, Kryesi e punës, ministra dhe deputetë të nderuar,
Në parim përkrahu Projektligjin mbi vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas mendimit tim, ky Projektligj është i shkurtër por edhe mjaft përmbajtësor. Me disa plotësime të vogla, që ka vend të bëhen, Projektligji do të kompletohet më mirë dhe është me interes për të gjitha komunat që në afat sa më të shkurtër të hyjë në zbatueshmëri.

Neni 6, është shkalla e tatimit. Sipas këtij Projektligji, shkalla e tatimit është paraparë të jetë 0.05 dhe 2% dhe sigurisht është menduar deri në 2% të vlerës së pronës.

Neni 8, zbritja për banimin parësor. Zbritja të bëhet me ndonjë parametër tjetër e jo me një vlerë zbritjeje prej 10.000 euro nga vlera e pronës. Propozoj që zbritja të bëhet me përqindje dhe kjo do të ishte më reale.

Neni 12, vlerësimi i pronës, pika 12.1. Propozoj që edhe prona e ndërtuar në mënyrë unike, duhet të ketë standarde të përcaktuara në mënyrë të qartë. Pika 12.3, propozoj që komunat të rishikojnë dhe rivlerësojnë blerjen e tregut të pronës çdo vit sepse vlera e tregut varion çdo ditë. Propozoj që të parashihet norma – shkalla e amortizimit dhe të përcaktohet në mënyrë të qartë sepse në Projektligj nuk është paraparë.

Neni 15, shtyrja e tatimit, pika 15.1. Propozoj që edhe rastet e veçanta të shtyrjes së tatimit, duhet të jenë shumë të precizuara, sepse në praktikë mund të keqpërdoren nga komuna. Pika 15.2....

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ibush, vetëm një moment. Këto janë çështje të amendamentimit. Ju lutem t' bëhen diskutime në parim.

IBUSH JONUZI:

Më fal, e përfundova. Duhet të precizohen cilat dëshmi duhet t' i parashtrijë pala në mënyrë që të bëhet shtyrja e tatimit dhe, vjelja e detyrueshme – duhet të parashihet se në

çfarë forme palës t' i parashtrihet kërkesa dhe me këtë mendoj se me aprovimin e këtij Projektligji çështja e mbledhjes së tarifave do të shkojë në favor të të gjithë neve. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi, le të bëhet gati Bajrush Xhemajli.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra të pranishëm,
Vlerësoj se nevoja, qëllimi, prioritetet dhe bazueshmëria e nxjerrjes së Ligjit mbi vendosjen e tatimit mbi pronën e paluajtshme në Kosovë u dha në pjesën hyrëse, është dhënë edhe në pjesën hyrëse të tekstit, por mendoj se ky Ligj lehtë është të aprovohet dhe vështirë është të zbatohet në praktikë nga fakti se mungon ligji mbi pronën dhe problemet rreth kësaj procedure na janë pothuaj të gjitha të njohura.

Megjithatë, duke lexuar dhe analizuar këtë Propozimligj, vendosa të paraqes disa sygjerime të mia në fazën e parë, të cilat mendoj se do t' i paraqes me konkretizim edhe me amendamente:

1. Duhet të kemi të ditur faktin se në këtë Ligj nuk është përcaktuar në mënyrë të plotë dhe duhet të përcaktohet në mënyrë të plotë pronari i vërtetë i pronës dhe atë me dëshmi të vlefshme juridike si titullar i një prone të caktuar nga se që nga viti 1999 e këndeje, në kohën kur shqiptarët u dëbuan me dhunë nga puna, ata u dëbuan me dhunë edhe nga banesat e tyre dhe në këtë mënyrë, në mënyrë të padrejtë, humbën të drejtën e titullarit të pronës së banesës, pra të banesës si bartës i të drejtës banesore nga se pastaj banesat, me ligjet diskriminuese, u blenë shumë lirë dhe u regjistruan shumë lehtë si prona të paluajtshme të personave që nuk i kanë merituar dhe marrë në procedurë të rregullt dhe dokumentacioni është qitur jashtë Kosovës, janë ndryshuar emrat, janë

ndryshuar bartësit e të drejtës banesore, janë ndryshuar adresat e pronarëve të vërtetë dhe investuesit dhe këtu lindin problemet që i thash në fillim.

2. Ky Ligj, nuk përcakton plotësisht standardet për caktimin e pronës mbi pronën e paluajtshme, as procedurën e plotë, nga se të ardhurat e mbledhura nga tatimi mbi pronën mbesin në komunë; çfarë të bëhet me pronat që gjenden në territorin e komunës, por nuk janë të evidentuara si prona të komunës, të një ministrie apo të një shërbimi konkret dhe gjenden të ndara në një pjesë tjetër. Këtë do ta konkretizoj.

3. Si do të zgjidhet çështaj e tatimpaguesit, i cili është pronar i vërtetë i pronës së paluajtshme, pra është bartës i të drejtës banesore por nuk shfrytëzon banesën dhe nuk ka shansë as ta argumentojë se është bartës i të drejtës banesore përmes Habitatit që funksionon tani në Kosovë.

4. Vlera e banesës tatimore duhet të bëhet mbi baza unike në tërë Kosovën, nga se shkalla tatimore nuk mund t'u lejohet komunave të caktojnë në bazë të asaj vjetore prej 0,05 deri në 2% e të vlerësohet prona sepse qytetarët duhet të jenë të barabarët para ligjit dhe para pronave dhe vlerave që ata i shfrytëzojnë.

Pastaj, Ligji nuk jep sqarime të duhura dhe të plota lidhur me praninë gjegjësisht përjashtimin nga tatimi; cilat janë kriteret që duhet t'i plotësojë një person i cili do të lirohet gjegjësisht do të përjashtohet nga tatimi i pronës mbi pronën.

Ligji duhet të përcaktojë se cilat kategori të qytetarëve duhet liruar nga tatimi mbi këtë pronë të paluajtshme.

8. Si do të bëhet regjistrimi i pronës së paluajtshme të 12.869 pronarëve shqiptarë që kanë pronat e paluajtshme në Mitrovicën veriore; dokumentacionin mbi të drejtën e pronësisë dhe pronës së paluajtshme; dokumentacionin mbi organin që ia ka ndarë banesën; iu janë djegur; iu janë shkyer nga forcat serbe paramilitaro-ushtarake e tjera, e tjera. Dhe, kjo procedurë as që ka filluar dhe konkretisht 8.833 denoncime mbi pronësinë që janë bërë në Mitrovicë as që është luajt në lëvizje të tyre për t'i dëshmuar.

Me këtë Propozimligj, autoriteti komunal kadastral duhet t'ua mundësojë qytetarëve të vet realizimin e kësaj të drejte, si dhe do t'i mbledhë ato tatime po qe se lëshohen fakturat tatimore, regjistrat dhe dokumentacioni parimor rreth shfrytëzimit të së drejtës banesore. Që më parë duhet të përcaktohen me ligj kushtet për shlyrjen e tatimit e mos të lejohet që kjo sipas vullnetit të autoritetit kadastral komunal apo funksionarëve komunalë t'i shlyhet dikuj e dikuj mos t'i realizohet kjo dhe nga kjo të lindin korrupcini, mitoja, njoftësia, familjarizmi dhe format tjera.

Mendoj se neni 33 i Ligjit, që fuqizon këtë Ligj, duhet të fshihet sepse nuk përmbush kriteret që saherë këtu janë cekur. Ligji nuk hyn në fuqi më 1 prill 2003 por hyn atë ditë kur e miraton Kuvendi dhe nënshkruan kryetari i Kuvendit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Xhemajli, le të bëhet gati deputetja Liljana Keniq.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Të nderuar të pranishëm,
I bashkëngjitem atyre që thanë se vërtetë është një absurd që të qitet Projektligji në diskutim që ka të bëjë me tatimin mbi pronën, kurse ligji mbi pronën të mos jetë i nxjerrur. Sidoqoftë, unë do të pajtohem që në parim ky Ligj të kalojë për shkak se sigurisht ligji do të plotësonte edhe një pjesë të vakumit në kuadër të përgjithshëm të legjislacionit në Kosovë dhe është aq më i nevojshëm kur dihet se ky Ligj është ndër burimet kryesore të buxhetit qoftë të komunave apo të shtetit në përgjithësi, andaj nxjerrjen e tij sa më të shpejtë e përkrah në këtë kontekst. Por në këtë fazë të shqyrtimit duhet theksuar një çështje. Është e vërtetë se Projektligji është në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare por krahas kësaj mendoj se kur hartohet një projektligj duhet të mirren fort parasysh edhe rrethanat e asaj shoqërie mbi bazën e së cilës zbatohet apo vepron ai ligj.

Konsiderojmë se te neni 17 – paragrafi 2,3,4,5 ku sanksionohet vjelja e detyrueshme dhe neni 18 paragrafi 2,3,4 në lidhje me humbjen e pronës. Mandej edhe te neni 19, paragrafi 3,4 ku sanksionohen ndëshkimet nuk janë marrë parasysh sa duhet rrethanat tona ku papunësia është në kulm dhe mbi 90% e banuesve jetojnë në pronat e tyre, domethënë shtëpi apo banesa dhe tash shtrohet çështja thjeshtë: si do të zbatohet Ligji në familje që janë aq të shumta pa asnjë të hyrë dhe nuk janë shtresë e vogël e popullsisë që nuk kanë të hyra sa nuk mund ta paguajnë tatimin për banim. Dhe, sikur të ishte i ulët ky tatim, e unë mendoj se nuk është bash i ulët, në këtë kontekst dua të them se vërtetë është bërë Ligji sipas standardeve ndërkombëtare por standardi ynë nuk është as përafërisht sa standardi jetësor në nivel të vendeve ku është marrë shembulli apo paralelja e këtij ligji. Në këtë formë, të tjerët, nëse nxjerren prej banesës, kanë një zgjidhje ta zëmë dhe të shkojnë me banesë dhe paguajnë qira, kurse këtu te ne nuk dihet por ka gjasë që në këtë mënyrë siç është këtu, njerëzit që nuk kanë të ardhura mund të mbesin edhe pa shtëpi. Prandaj, këto tri nene, me ato paragrafet që potencova, është mirë të rishikohen dhe sado-kudo të zbutet kjo çështje, e cila mendoj se është shumë e theksuar. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Liljana Keniq, le të bëhet gati zoti Kurteshi.

LILJANA KENIĆ:

Poštovani poslanici, poštovani predsedniče Skupštine i poštovani ministre, Pre nego što odlučim da li ću podržati ovaj zakon ili da glasam u načelu za taj zakon, imam određena pitanja za gospodina ministra i zamolila bih da mi pojasni, pre svega, član 4. stav 2. koji glasi: "Ukoliko se vlasnik nekretnine ne može odrediti ili naći, poreski obveznik biće fizičko ili pravno lice koje koristi ili okupira nekretninu". Zašto je izostavljen pravni osnov korišćenja nepokretnosti i s tim u vezi, da li će oni koji su uzurpirali srpsku imovinu plaćati porez za tuđu imovinu umesto da odgovaraju za uzurpaciju i povredu principa neprikosnovenosti privatne svojine.

Drugo, šta podrazumeva "pod okupacijom nepokretnosti"? Da li podrazumeva - ničiju svojinu ili podrazumeva - napuštenu imovinu? Da li pod napuštenom imovinom podrazumeva dobrovoljnu napuštenu sa izjavom vlasnika o odricanju imovine ili prinudno napuštanu imovinu.

I treće, pitanje je - šta će biti sa nepokretnom imovinom raseljenih i izbeglih lica? Obizorm da interno raseljena lica nisu u mogućnosti da plate porez za svoju imovinu, da li će se na osnovu člana 18. ovog Zakona, a protekom dve godine, zbog neizmirenih dugova za neplaćeni porez, oduzeti nepokretna imovina i prodati na javnoj aukciji. Zašto ministar nije predvideo u članu 7. Oslobođanje od poreza na nepokretnu imovinu izbeglih i raseljenih lica - da se oslobodi njihova imovina do njihovog povratka.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Një moment, zoti Kurteshi. Unë do të propozoj që ministri në fund të rezymojë në pyetjet e të gjithëve që të mos dalë çdo herë, nëse pajtoheni. Zoti Kurteshi e ka fjalën, le të bëhet gati Fadil Kryeziu.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, zoti ministër, të nderuar deputetë, Mendoj se miratimit të këtij Ligji duhet t'i paraprijë regjistrimi i pronës së patundshme. Me sa jam i informuar, në komuna të tëra dhe sidomos nëpër enklavat serbe, kjo nuk ka ndodhur për shkak të moslejimit dhe s'e di si mund ky Ligj të tatimojë prona të paregjistruara. Meqë ne aprovojmë ligje që të vlejné për tërë Kosovën, konsideroj se së pari duhet të regjistrohet prona. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Fadil Kryeziu, le të bëhet gati Sadik Idrizi.

FADIL KRYEZIU:

I nderuar kryetar, zoti ministër,

Unë mund të ngreh në parim tri çështje, ndoshta shkurt, që do t'u sygjeroja komisioneve kompetente që t'i kenë parasysh. Në radhë të parë, gjatë ekspozesë së ministrit, dëgjova sikur komuna mund të vendosë shkallën tatimore të tatimit në baza vjetore ndërmjet 0.05 deri në 2% të vlerës së pronës, që shkruan në Ligj, ndërkaq, kuptova, nëse kam dëgjuar drejt, deri në 0.2%. Unë do të sygjeroja që kjo shkallë, pra limitimi deri në 2%, të bie më poshtë, pra të rrëzohet në nivel më të ulët e cila do të diktonte, domethënë, një shtrirje më të gjerë horizontale në mbledhjen e tatimit mbi pronën dhe do të mundësonte që qytetarët të kanë mundësi të kryejnë këtë kontribut të tyre ndaj tatimit në shkallë më të gjerë.

Çështja e dytë, që do të ngreh, është çështja – Prona e përjashtuar nga tatimi, pra neni 7 pika 7.1 b), rreshti i parë e deridiku edhe rreshti i dytë – Prona në pronësi apo në shfrytëzim të një qeverie të huaj; agjencionit të qeverisë së huaj; organizatave ndërkombëtare qeveritare ose agjencionit, donator e tjerë, të huaj. Unë do të thosha këtu se nuk është krejtësisht qartë e precizuar se çka nënkupton prona në pronësi apo në shfrytëzim të një qeverie të huaj dhe kam parasysh pra personalisht - zyrat diplomatike, ambasadat apo të ngjajshme. Mirëpo ngreh këtë çështje me qëllim që të precizohet qartë, nga se ju e dini, disa qeveri të Ballkanit, pra shteteve të Ballkanit, pretendojnë në prona të caktuara në Kosovë dhe për më tepër nxjerrin edhe sisteme ligjore që të marrin ose të blejnë nga qytetarët kosovarë prona të tyre dhe më pastaj të thirren në këtë dhe pra ta gëzojnë këtë benifit të largimit ose përjashtimit nga tatimi. Këtë duhet ta kemi parasysh dhe të precizohet më qartë.

Dhe çështja e tretë, në botën demokratike, sidomos te banimi ose zbritja për banimin parësor, në fakt të objekteve për banimin parësor. Të gjithë qytetarët e një shteti që vendosin të investojnë në objektet për banimin parësor, kanë benefite pra edhe në tatime të caktuara që përjashtohen për një periudhë të caktuar kohore, domethënë për faktin se ata investojnë në ndërtesa banimi për zgjidhjen e problemeve të banimit të qytetarëve. Prandaj, do të ishte mirë të përfshihet edhe kjo në ndonjërin nga pikët e këtij Ligji. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Sadik Idrizi.

SADIK IDRIZI:

Poštovani predsjedniče, poštovani ministri, drage kolege,
 Ovaj Zakon je neophodan za funkcionisanje sistema odnosno svakog društva svake zajednice i mislim da je bio neophodan. Mi smo očekivali da će biti rasprava o ekspozeu premijera, međutim ona je odlagana i odlaže se dva puta i danas o tome ne govori. Prilikom usvajanja Programa Vlade, mi smo pokrenuli pitanje oduzete imovine građanima koji pripadaju mojoj zajednici Bošnjačko-goranskoj. Na Kosovu su tokom rata i nakon rata imovinu izgubile gotovo sve zajednice, u zavisnosti od mesta gde su živele i kakav je danas raspored snaga. Ne znači da je izgubila samo jedna zajednica, druga i treća. Znači, neka je zajednica više izgubila, neka manje ali to najbolje znaju oni koji su je izgubili. Četiri godine nakon rata neki ne mogu da se vrate u svoje kuće, u svoje stanove, mnogi su izgubili komercijalnu imovinu. Samo je iz Gore registrovano oko 90 oduzetih lokala na Kosovu i nijedan nije vraćen. Mnogi ljudi su izgubili osnovna sredstva za život. Ako se računa da su od tih lokala živeli i po nekoliko članova, desetak članova porodice i tako dalje, danas je ogroman broj ljudi koji traži... Kako utvrditi, tamo nekim članovima koji su zaista diskutabilni, verovatno ćemo čuti obrazloženje ministra, ono što je pomenuto u članu – ako se vlasnik ne utvrdi, onda se ta okupira ili ne znam kakav termin je iskorišćen. Ne može plaćati neko porez za imovinu za koju nema dokaza da je njegova. Znači ušao je u nečiji stan, u nečiji lokal i sada može da plati porez na to. To je neshvatljivo, i mislim da je to ... Sutra će doći da je on plaćao porez i da će imati pravo da to bude njegovo. Mislim da je neophodno, neophodno i pored ovog zakona, na jedan način najadekvatnije regulisati. Mi smo planirali da se u Vladi Kosova... Postoji Habitat, ali to su neki zamršeni putevi, dugotrajni i ne znam koliko traju bez kraja i konca, traže rešenja neka sudska čoveku koji je vlasnik, koji ima potvrdu da je to njegovo, kažu donesi rešenje od suda da je to tvoje ili ne znam kako. Mislim da su to besmislene stvari. U Vladi ili u kosovskim institucijama tražimo da se formira telo komisija koja će raditi na ovim pitanjima i da se sutra zna kome da se uputi šta si uradio za godinu-dvije, jesi nekome vratio imovinu i tako dalje. Bez razlike, danas je možda, ja govorim u ime moje zajednice međutim ima i takvih koji su u severnoj Mitrovici i ima takvih širom Kosova, u gradovima, po centrima, ljudi su ostali bez imovine više godina i moramo posmatrati – privatna svojina je svuda u svetu svetinja. Na zapadu, na prvom mestu je bog, na drugom je privatna svojina. Moramo, ako sledimo zapad, po nekim stvarima i po ovim pitanjima da mu se približimo. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuar kryetar, të nderuar ministra, deputetë,
 Ne, Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim, përkrahim Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme dhe mendojmë se ky Projektligj mund të procedojë më tutje. Ne kemi një vërejtje që do të duhej Komisionit funksional, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, ta rishikojë edhe një herë çështjen te neni 18 – Humbja e pronës. Mendoj se është shkelje e së drejtës elementare të njeriut humbja e dhunshme e pronës për shkak të mospagimit të tatimit. E kam fjalën për persona fizikë, jo për persona juridikë dhe për pronat që sigurojnë ekzistencën e personave fizikë, në radhë të parë edhe për pronat banesore, shtëpitë e banimit dhe që shërbejnë vetëm për sigurimin e ekzistencës së personave fizikë dhe të familjes ose individit. Kjo është pronë e shenjt dhe këtë nuk mund komuna dhe asnjë qeveri t'ia shesë pronën atij për shkak të mospagimit të tatimit. Tatimin në pronë, siç tha edhe ministri, e merr komuna ose qeveria apo kushdo tjetër për obligimet që i kryen komuna ndaj individit, ndaj qytetarit dhe të mund t'i kryejë ato më mirë. Komuna mund ta dënojë personin fizik me moskryerjen e obligimeve komunale ndaj tij, por jo edhe me shitjen e pronës që shërben për ekzistencën e personit. E tha një kolegë më herët: Jo mund të ndodhë, por në bazë të këtij Ligji ai që s'mund ta paguajë tatimin në banesën e vet, nxirret në rrugë. Kjo do të ishte cenim i të drejtës së individit për të poseduar pronën për ekzistencën e vet. Po ashtu, në këtë çështje, nuk është e definuar si duhet në këtë Projektligj - te Humbja e pronës, është shumë e padefinuar. Thotë: i shitet krejt prona! Do të thotë njeriu mund të mos ketë paguar, ta zëmë, 500 euro në vit tatimin dhe i shitet prona, ta zëmë, që ka vlerë 50 mijë euro dhe kjo nuk mund të jetë kështu.

Në programet që kanë qenë, si pilotprogrami në vitin e kaluar, ka shumë paqartësi. Qytetari paguan tatim dhe nuk e ka të ditur saktësisht përse e paguan tatimin. As në ato listat përcjellëse e as në rregulloren e UNMIK-ut nuk është krejt e saktësuar dhe qytetari paguan por nuk e ka të ditur në cilën kategori, pse paguan dhe qysh e paguan. Mendoj se këto çështje duhet të qartësohen, e sidomos tek cenimi i së drejtës elementare të personave fizikë për të poseduar pronën private. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se t'ua jap fjalën, kam një vërejtje. Është shqyrtimi i Ligjit në parim, e jo shqyrtimi dhe analizimi i fjalëve që thonë deputetët. Do t'ua jap fjalën të gjithëve, por ju lutem, ata që kanë analizuar Ligjin dhe dojnë të diskutojnë në parim, le të urdhërojnë. Fjalën e ka zoti Hasan Meta, le të bëhet gati zoti Rangjell Nojkiq.

HASAN META:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë, zoti ministër dhe ministra,
Do të pajtohesh në parim me të gjitha këto që u thanë, por diçka s'e kam të qartë këtu dhe do ta lutja ndoshta edhe zotin ministër por edhe komisionet të cilat do të punojnë në këto nene... Neni 7, ku përjashtohet tatimi në disa prona, duke u nisur nga pikat a), b), c), d) dhe e) mendoj se do të duhet të punohet pak më shumë dhe të shikohet arsyeshmëria e këtij neni dhe këtyre pikave prej a) deri në e). Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

E fjalën zoti Nojkiq, le të bëhet gati Sabit Rrustemi.

RANDEL NOJKIĆ:

Radno Predsedništvo, dame i gospodo,
Pa ja moram da vam kažem, ja ću zaista da diskutujem u načelu o ovom zakonu i mislim da ovaj Zakon nije smeo danas da se stavi na dnevni red, s obzirom da on legalizuje nešto što zapravo znači neprikosnoveno pravo a to je pravo na imovinu. Ovaj zakon, zapravo je prejudiciran, mislim da ovaj... on hoće da legalizuje nešto što je uzurpirano, nešto što je pravo, što je neprikosnoveno pravo... Ja sam želeo takođe da čujem prvo mišljenje gospodina ministra nego plašim se da neću da imam priliku jer kako je najavljeno on će dati mišljenje na kraju i ja apelujem na sve one, koji smatraju kao ja da je pravo na imovinu neprikosnoveno, da ne glasaju za ovaj zakon. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Fadil Kryeziu, le të bëhet gati Sabit Rrustemi.

FADIL KRYEZIU:

Zoti kryetar, unë kërkoj ndjesë që për së dyti po paraqitem, por do të jam shumë i shkurtër. Në nenin 4, është një dallim, domethënë në gjuhën serbishte dhe në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe, fare nuk shkruan "personi i cili e okupon ose ka okupuar pronën", ndërkaq këtu dikush e ka përkthyer dhe thotë: "personi i cili e shfrytëzon apo e okupon pronën", domethënë se është një dallim dhe shoh se këtu diskutohet nga

parafolësit rreth kësaj që mund të vëjë gjërat në dilemë. Prandaj, proozoj që të harmonizohet përkthimi në të dy gjuhët.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë E ka fjalën Sabit Rrustemi, i fundit.

SABIT RRUESTEMI:

I nderuar kryetar, Kryesi, deputetë dhe ministra, Unë dua të ngris vetëm një çështje këtu dhe, në raport me ministrin, sigurisht do të japë shpjegime. U përmend shumë çështja e titullarit të pronës dhe shfrytëzuesit. Mirëpo, në Kosovë kemi edhe një problem tjetër në këtë aspekt. Ne kemi prona të cilat për momentin nuk kanë pronarë por as nuk kanë shfrytëzues, sidomos nëpër viset rurale kodrinore-malore. Pronarët e këtyre pronave sot jetojnë nëpër shtete tjera jashtë Kosovës, sidomos në ish republikën jugosllave të Maqedonisë por kemi edhe pronarë të tjerë që kanë braktisur pronat dhe sot jetojnë në komunat tjera. Kam parasysh gjithnjë komunën e Gjilanit, në këtë aspekt. Prandaj, si do të sillemi ne me këto prona që, them kushtimisht, janë prona të braktisura dhe kush do t'i shfrytëzojë ose kush do të tatimohet për to. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zoti ministër a doni të jepni sqarime lidhur me këtë?

ALI SADRIU:

T'falemnderit, zoti kryetar. U orvata të marr të gjitha refleksionet tuaja dhe s'di sa do të përgjigjem në mënyra specifike, sepse në diskutimet e disave rreth neneve, ka pasur nene të caktuara që edhe kryetari i Parlamentit tërheqi vërejtjen se ato mund edhe të riparohen apo të sqarohen gjatë miratimit të neneve. Parimisht, ky Ligj, flet për tatimin mbi pronën. Ky nuk është ligj i pronës. Dikush këtu tha, nëse dojmë të shkojmë në perëndim, apo të integrohemi në perëndim, duhet të veprojmë në harmoni me rregullat dhe standardet që janë në perëndim. Unë ju garantoj se ky Ligj ka m'u atë esencë në thelbin e vet. Ky Ligj qartëson, për aq sa ka mundësi, në rrethanat të cilat jeton Kosova, titullarin e pronave përmes regjistrave të kadastrit. Mirëpo, ky Ligj, po ashtu, ngarkon ata që janë shfrytëzues të pronave. Fjala "okupim" nuk ka ta bëjë me brendinë e prezentimit të këtij ligji. Është fjalë që është hudhë, e unë kërkoj falje që nuk kam parë tekstin në gjuhën tjetër. Fjala është për shfrytëzuesit. Të ju përkujtoj se në perëndim, tathen edhe

bizniset ilegale, të cilat i ndjek policia, i dënon policia por administrata tatimore kudo që ka mundësi, aty ku krijohen të ardhurat, ajo e vë tatimin, çka nënkupton se tatimi nuk legjitimon titullarin e pronës, por ajo e ngarkon shfrytëzuesin. Kjo është parimisht një çështje që duhet ta sqaroj për të gjithë.

Çështja tjetër që disa ngritën këtu, është fjala e “shkallëve të përcaktimit”. Vlera e një objekti, që do të jetë objekt i tatimit, ndryshon nga qyteti në qytet. Këtë e dijme të gjithë, ajo ndryshon edhe nga zona në zonë, në Prishtinë ta zëmë – në qendër dhe në periferi. Prandaj, i është lënë hapësirë kuvendeve komunale, me ekipe profesionale, të bëjnë përcaktimin e tyre. Thamë, ky tatim është i bazës së gjerë të tatimit dhe për atë norma është e ulët. Këtë tatim nuk po e aplikojmë sot. Ky është aplikuar dhe ka operuar gjatë gjithë vitit 2002, por në një formë tjetër dhe me një rregullore që është quajtur pilotprogram dhe ne po pretendojmë që ajo rregullore, tani kur janë zgjedhur institucionet, të kalojë në ligj. Do të thotë, nuk ka kurgjë të re nga ajo që është operuar gjer tani. Nga praktika, mund t’ju them këtë se tatimi është i ulët. Unë shfrytëzoj një banesë tredhomëshe që 25 vite, paguaj diku 60 deri 70 euro për tërë vitin dhe ajo mund të paguhet në dy rata. Është fjala tjetër për bizneset, për objektet e biznesit, ku vlera e tyre është sigurisht, sipas vlerësimeve të komisioneve, diçka tjetër.

Edhe një çështje do ta sqaroj. Nëpër të gjitha kuvendet komunale ekzistojnë komisionet gjatë vlerësimit, kategori të cilat nuk mund të ngarkohen dhe lirohen si familje që janë nën asistencë familjare e tjera, e tjera. Do të thotë, peshohet edhe fuqia e çdo familjeje që është shfrytëzues i asaj prone dhe më pastaj përcaktohet norma e tatimit. Është krejt normale kur flitet për tatimet e mbledhura me dhunë. Në rrethana kur vlerësohet se tatimpaguesi, shfrytëzuesi në këtë rast, posedon por në rrethana të caktuara nuk don ta paguajë, është krejt normale dhe çdokund zbatohet ligji dhe do të zbatohet edhe te ne.

Unë u orvata kështu në pika të përgjithësuara, duke mos u lëshuar në specifika, siç ishte për shembull amortizimi dhe ju vetë propozuat që gjatë një viti duhet të vlerësohet. Nëse vlerësohet, ajo eliminon edhe elementin e amortizimit, do të thotë vlerën që ka patur në vitin e kaluar dhe unë ndaj atë mendim se vlerat e patundshmërisë në Kosovë janë abnormale për shumë vende tjera. Unë kam patur rastin me vende të një tempore shumë më të lartë se tonën dhe kur kam sqarue se sa është një pronë, ta zëmë, në Prishtinë – kanë mbetur pa tekst dhe kjo ka shkaktuar çrregullime demografike. Është proces i çrregullimeve demografike, si një vend i pasluftës dhe në rrethana kur vijnë duke u qartësuar, sigurisht se vlerat e pronave do të jenë tjera. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti ministër ju falemnderit. Me këto sqarime të dhëna, përfundoi debati. Tani besoj se mund të shkojmë në votim për aprovimin e Ligjit në parim.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 9 vota kundër.

A abstenon ndokush? 4 abstenime.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për - Za - For:.....	Shumica – Veçina - Majority
Kundër – Protiv – Against.....	09
Abstenuan – Uzdržanih – Abstained.....	04

Ju falemnderit dhe lus komisionet që kanë në shqyrtim, ta përshejtojnë punën gjegjësisht të punojnë punën normale.

Tani, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – **Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, më 3 prill 2003** dhe atë, si vijon:

1. **Debati lidhur me ekspozenë e kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë;**
2. **Do të vazhdojmë, nëse janë të gatshme strukturat për raportin lidhur me gjendjen e gjyqësisë, sepse vendosëm kështu;**
3. **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bibliotekat, dhe**
4. **Shqyrtimi i Propozimit për miratimin e Inisiativës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional.**

T'ju informoj se për pyetjet e parashtruara nga deputetët, nuk ka konfirmim as me shkrim as me gojë prej atyre që duhet të jipen përgjigjet.

Urdhëroni, Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA:

Qe për të satën herë, Komisioni për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë luftës, ka kërkuar që çështjen ta shqyrtojmë në ndonjëren mbledhje plenare. Kërkoj nga Kryesia që urgjentisht këtë çështje ta parashtrrojë në rend dite për mbledhjen e ardhshme.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Le të shkojë kjo në procedurë në Kryesi dhe do të vendoset për këtë. Urdhëroni, Muhamet Kelmendi.

MUHAMET KELMENDI:

I nderuar zoti kryetar, zonja dhe zotërinj,

Në qoftë se në një seancë të Kuvendit ne nuk votojmë për rendin e punës, atëherë është e rrugës, sikur që është vepruar këtu, që në seancën paraprake të diskutohet për rendin e punës dhe të vendoset, që këtu sot të diskutohet për rendin e punës dhe bashkërisht të vendosim për rendin e punës për seancën e ardhshme. Në të kundërtën, nuk ka logjikë që ne sot të mos diskutojmë, ndërsa në javën e ardhshme në seancë pastaj të punojmë sipas rendit të punës ende pa u diskutuar dhe pa vendosur deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Unë kam vetëm një çështje, për të cilën mendoj se duhet të shtrohet në seancën e ardhshme, sepse është çështje shumë urgjente. Është fjala e kalimit të kompetencave, qysh është bërë praktikë të thuhet, nga faktori ndërkombëtar UNMIK-u tek Qeveria e Kosovës dhe organeve tjera të cilat janë të Kosovës.

Këtu është bërë njëfarë shtjellimi, mund të them, në këtë mënyrë të kalimit të kompetencave. Sepse, në qoftë se është fjala për për kompetenca, të cilat janë të përcaktuara në Kornizën kushtetuese, që janë në kompetenca të organeve të Kosovës, atëherë nuk kemi të bëjmë me kalimin e kompetencave por kemi të bëjmë me një çështje tjetër se organet e Kosovës nuk kanë marrë ato kompetenca dhe duhet të dalin para këtij Kuvendi dhe të tregojnë shkaqet që kanë sjellë organet e Kosovës, qoftë Kuvendin, qoftë Qeverinë dhe kryetarin që të mos kenë kompetenca të cilat kanë qenë të përcaktuara.

Së dyti, në qoftë se është fjala për bartjen e kompetencave, sipas Kornizës kushtetuese të kompetencave që janë të përziera...(Ndërprerje e tonit)... atëherë duhet që të vijmë këtu dhe të diskutojmë për ato kompetenca sepse duhet të bëhen ndryshime në amendamentet kushtetuese dhe në qoftë se është fjala për kompetenca të rezervuara që kanë qenë tash për Sekretarin e Përgjithshëm, që është përfaësues i sekretarit të përgjithshëm, atëherë natyrisht përsëri ky Kuvend ka për detyrë ta shqyrtojë nxjerrjen e amendamenteve. Pra e shoh të rrugës dhe propozoj që në rend të punës, në javën e ardhshme, të dalë kjo çështje para këtij Kuvendi dhe të nxirren amendamente për çështjet për të cilat duhet të barten kompetencat nga faktori ndërkombëtar tek vendësit. Këtë desha ta them.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Ju lutem, s'kemi nevojë të ngutemi. Rregulla e kërkon, shefi i grupit parlamentar mund të bëjë propozim dhe pastaj të përcaktohem. Prandaj, kjo nuk është çështje e debatit. Në qoftë se një grup parlamentar ka dëshirë të fusë diçka për seancën e ardhshme, atëherë e votojmë që të shihet a pranohet apo jo.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, ju e dini se parashihet që edhe deputetët mund të propozojnë çështje të ngutshme dhe këtë e kemi bërë zakonisht në fillim të mbledhjeve. Qe dy-tri mbledhje këtë e keni hequr nga rendi dhe ju duhet të gjeni një moment kur ne si deputetë, ne që s'jemi as shefa të grupeve as shefa të komisioneve, por megjithatë jemi deputetë, të na jipet mundësia që të propozojmë ndonjë çështje. Dhe, përherë, kur diçka ndodh në mes dy seancave, ne kemi të drejtë të propozojmë, prandaj unë po e shfrytëzoj atë drejtë dhe propozoj që, meqë s'na u dha mundësia në fillim, të propozojmë pikë të rendit të ditës dhe për mbledhjen e ardhshme të hyjë në rend të ditës pengimi i paralelizmave në Kosovë dhe atë me këtë arsytim: – se në Kosovë paralelizmat janë bërë diçka e zakonshme. Para disa kohe është formuar kuvendi i bashkësive të komunave serbe në veri të Kosovës, më 23 mars në Anamoravë është themeluar kuvendi i bashkësive të komunave serbe të Anamoravës që përfshin komunat Gjilan – Dardanë – Viti dhe Artanë, prandaj propozoj që kjo çështje të futet në rend të ditës dhe të diskutohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Askush deputetëve nuk ia ka cenuar të drejtën dhe as që ka në plan, zoti Kurteshi. Rregullat janë të qarta. Çështje të ngutshme që ngrit një deputet, por jo grupi parlamentar, vlerëson kryetari, ai që udhëheq ose ai që e kam caktuar zëvendës. Kjo çështje nuk është çështje e ngutshme, dhe nuk kontestoj përmbajtjen. Qeveria duhet të deklarohet sepse është në procesin e bartjes së përgjegjësive dhe është çështje shumë serioze, jo çështje e ngutshme që një deputet ta shtrojë. Urdhëroni, ju shefi i Grupit Parlamentar, Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Unë pajtohem me idenë që paraprakisht të bisedojmë për seancën e ardhshme dhe është e mirë, por duhet të kemi kujdes në Rregullore dhe ta rrespektojmë atë. Rregullorja parasheh, Rregulla 19.3 dhe 4, obligativisht Kryesia është e obliguar t'i ftojë shefat e grupeve parlamentare dhe të konsultohet për rendin e ditës, nën një. Dhe, nën dy, Kryesia është e obliguar që të paktën një herë në muaj t'i ftojë dhe bisedojë me grupet parlamentare për procedurat e punës të Kuvendit, kështu që kjo nuk përjashton atë por Rregullorja nuk po zbatohet në këtë drejtim sa i përket rendit të ditës dhe këtu po dalin

mosmarrëveshje. Unë kërkoj që ajo të rrespektohet dhe të fillojmë të punojmë duke rrespektuar Rregulloren. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Me këtë, e konsideroj të mbyllur seancën e sotme. Shihemi në seancën e ardhshme.

Seanca përfundoi në orën 11,30.